



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
OSNOVNI SUD PRIŠTINA - BASIC COURT OF PRISTINA

---

AD/GJTHPR/31/22

Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Kryetarja e Gjykatës, Albina Shabani Rama, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga D.B, për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit K.K, bazuar në dispozitën e Nenit 9, paragrafit 1 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7, paragrafit 1 dhe 3 të Rregullores Nr.05/2019 Për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, me datë 08.08.2022 merr këtë:

**V E N D I M**

Refuzohet si e pabazuar ankesa e ushtruar nga D.B ndaj gjyqtarit K.K, për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për inicim të procedurës disiplinore.

**A r s y e t i m**

Eksperti gjyqësor D.B ka ushtruar ankesë për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit K.K, e pranuar në Gjykatën Themelore në Prishtinë me datë 13.07.2022. Gjithashtu e njëjta ankesë është pranuar me datë 27.07.2022 përmes Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Me datë 28.07.2022 është njoftuar Këshilli Gjyqësor për pranimin e ankesës disiplinore të parashtruesit.

Parashtruesi D.B ka paraqitur ankesë disiplinore ndaj gjyqtarit K.K për shkak të pretendimeve se gjyqtari në seancën e datës 13.07.2022 në lëndën A.nr.2707/2018 ka ushtruar gjuhë të papranueshme për parashtruesin. Po ashtu, në ankesën e paraqitur, parashtruesi ka deklaruar se posa ka hyrë në zyrën e gjyqtarit kur ishte ulur i kishte mbajtur duart e kryqëzuara si dhe këmbët, ndërsa gjyqtari me gjuhë kërcënuese i kishte thënë se *“mos i kryqëzo duart, kjo sjellje është prishje e qetësisë së seancës gjyqësore”*. Parashtruesi iu kishte drejtuar gjyqtarit se *“kjo po më befason, se nuk paskam dëgjuar më parë”*, duke iu bindur kështu urdhrit të gjyqtarit. Por pas disa minutash, në mënyrë instiktive i kishte kryqëzuar duart, ku gjyqtari në mënyrë qortuese i kishte thënë *“a mundesh me qëndru ‘si njeri’”*, duke i thënë se mund ta ndëshkoi deri në 1000 €, pasi me këtë sjellje po e prish qetësinë e seancës gjyqësore. Ka konsideruar se sjelljet e gjyqtarit paraqesin shkelje të etikës profesionale.

Në lidhje me pretendimet e parashtruesit të ankesës, gjyqtari K.K ka deklaruar se janë të paqëndrueshme dhe të pavërteta pretendimet ankimore. Ka shtuar se, pas kthimit në rigjykim të lëndës A.nr.2707/18 nga Gjykata e Apelit, lëndë e cila paraprakisht ishte shqyrtuar dhe vendosur nga gjyqtari H.H, konform afateve ligjore, i ka dërguar ftesën për seancë gjyqësore të gjitha palëve ndërgjyqëse, duke përfshirë edhe ekspertin Dr. D.B. I njëjti fillimisht është ftuar për seancën e datës 06.06.2022 nga ora 09:00, ftesën e ka pranuar me datë 05.05.2022, por nuk ka prezantuar në seancën e kësaj date.

Tutje, gjyqtari i rastit ka theksuar se seanca e datës 13.07.2022 fillon me disa minuta vonesë për faktin që seanca paraprake zgjati më tepër sesa që ishte planifikuar, e kjo ndodh para së gjithash për shkak të deklarimeve shpesh të zgjatura të palëve apo vëllimit të madh të administrimit të provave në seancë. Në seancën e datës 13.07.2022 eksperti hyn me një qasje shumë arrogante, dhe

gjatë seancës disa herë i tërhiqet vërejtja që të ulet mirë dhe të respektoj rendin dhe qetësinë në Gjykatë. I njëjti në vazhdimësi i kundërshton këto thirrje të gjyqtarit të rastit duke pohuar se “mu këto rregulla po më duken të papranueshme”. Duke marrë parasysh se vërejtjen verbale, jashtë procesverbalit nuk ishin efektive në mbajtjen e rendit dhe qetësisë në gjykatë, gjyqtari i çështjes i tërheq vërejtjen me shkrim ekspertit ankues duke e ftuar të njëjtin që të ulet mirë dhe të respektoj rendin në gjykatë duke paralajmëruar të njëjtin me pasojat ligjore në rast të mos respektimit të rendit dhe qetësisë në gjykatë. Ky konstatim bëhet në procesverbalin e datës 13.07.2022. Eksperti ankues në vazhdimësi ka mbajtur qëndrim arrogant kundrejt Gjykatës, edhe pse i njëjti është ekspert gjyqësor dhe në rrethana normale do të pritej që të paktën nga një subjekt i tillë minimalisht të respektohet dinjiteti i Gjykatës dhe i gjyqtarit të çështjes.

Autoriteti kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, deklarimit të gjyqtarit dhe pretendimeve të parashtruesve të ankesës, ka vlerësuar se nuk ka dyshim të arsyeshëm për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit K.K.

Autoriteti i kësaj Gjykate bazuar në faktet e çështjes ka gjetur se, nuk ka bazë të arsyeshme për inicimin e hetimeve për shkelje disiplinore në veprimet e gjyqtarit K.K lidhur me mbajtjen e seancës së datës 13.07.2022.

Nga pretendimet e palës ankuese Autoriteti kompetent i kësaj Gjykate vlerëson se shkeljet e pretenduara disiplinore konsistojnë në: gjuhë të papranueshme të gjyqtarës dhe sjellje të papërshtatshme.

Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë vlerëson se në rastin konkret pas shqyrtimit të dosjes dhe shkresave të lëndës nuk ka arritur të provojë pretendimet e palës ankuese për gjuhën dhe sjelljet e papranueshme të cilat janë objekt i kësaj ankese disiplinore. Në këtë drejtim, parashtruesi i ankesës nuk ka pasur argumente bindëse se gjuha, respektivisht sjelljet e gjyqtarit të çështjes bien ndesh me Kodin e Etikës për gjyqtarë apo veprime të cilat hyjnë në domenin disiplinor. Sa i përket mbajtjes se rendit në gjykatë, dispozitat ligjore i japin kompetencë gjyqtarëve që të kujdesen për mbarëvajtjen e rregullt të një procesi gjyqësor dhe eventualisht të shqiptojnë masa - gjë përcaktohet me nenin 289 par.2 të LPK-së. Në këtë drejtim, nga procesverbali i seancës së datës 13.07.2022 konstatohet se ekspertit iu kishte tërhequr vërejtja që të “ulej mirë”.

Andaj, Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë lidhur me ankesën e ushtruar, bazuar në të dhënat e përshkruara më lartë, vlerësoi se nuk ka bazë të arsyeshme të besoj se gjyqtari ka kryer shkelje disiplinore, për t'i parashtruar Këshillit Gjyqësor të Kosovës kërkesë për fillimin e hetimeve disiplinore.

Nga të cekurat më lartë, në bazë të nenit 7, paragrafi 3, të Rregullores Nr.05/2019, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË  
AD/GJTHPR/34/22, me datë 08.08.2022

Albina Shabani Rama

---

Kryetare e Gjykatës Themelore në Prishtinë